

Studim për gjendjen  
iniciales me dhunën  
në shkollat fillore në  
Maqedoni

Studimin e përgatitën ekipi profesional i Qendrës  
Algoritëm në bashkëpunim me ekipin e Byrosë së  
zhvillimit të arsimit.

Disejmi: Koma lab.

Botoi: Vinsnet grafika

Tirazhi: 5.600 ekzemplarë

## Hyrje

Mjedisi shkollor është sipas moshës së nxënësit, ai është i mbrojtur dhe i sigurt, në të nuk ka shqetësime, dhunë dhe abuzim të fëmijëve.(1)

Dhuna ndaj fëmijëve është njëri nga problemet më serioze që rrezikon zhvillimin e tyre, shëndetin dhe mirëqenien, të drejtat themelore, dinjitetin dhe mundë të sjell në pyetje jetën e fëmijëve.

Ndodhën gjithkund, në shtëpi, në shkollë apo në institucione tjera për kujdesi të fëmijëve, në rrugë. Pjesa më e madhe e dhunës ndaj fëmijëve mbetet e fshehur. Fëmijët kanë frikë ta paraqesin për shkak se frikësohen ose për shkak të lidhjes që kanë me përdhunuesin apo dhunën aspak nuk e konsiderojnë si diçka të gabueshme ose të jashtëzakonshëm por e shohin si ndëshkim të justifikuar për veprimet e tyre.

Fëmijë që janë viktimë e dhunës mundet të ndjehen fajtorë dhe të besojnë se e meritojnë dhunën. Gjatë historisë, por edhe sot në kultura të ndryshme ndëshkimi fizik ka qenë/është njëra nga mënyrat për disiplinimin dhe edukimin e fëmijëve si në familje ashtu edhe në shkollë. [2].

Siguria dhe ndjenja e sigurisë të fëmijët në shkollë, si të drejta dhe nevoja themelore mund të sjellën në dyshim si pasojë e përvojës së hershme të dhunës. Siguria e fëmijëve në shkollë paraqet bazë për ndjenjën e përkatësisë shoqërore, si dhe për atmosferën e besimit dhe bashkëpunimit. Përgjegjësia e të rriturve për krijimin e kushteve sa më të mira për rritje dhe zhvillim të sigurt të fëmijëve konfirmohet

në Konventën për të drejtat e fëmijëve të kombeve të bashkuara. [3] Kështu, në nenin 19 nën pikën 1 përcaktohet përgjegjësia e shteteve nënshkruese të konventës „*të ndërmarrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore ,fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë edhe abuzimin seksual*”. Më tutje, në nenin 28, pika 2 thuhet se „*Shtetet palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me ketë Konventë*”.

Që këtu edhe përgjegjësia e bashkësisë shkollore, si tërësi, të tregoj angazhim të vazhdueshëm, politik të qartë se kujdeset për përparimin e marrëdhënieve, paralelisht me rregullativat për sjelljet e dhunshme. Dukuria e sjelljes së dhunshme në shkollat tona duhet të bëhet prioritet për zhvillimin e ndjeshmërisë për problemin të të gjithë anëtarët, jo vetëm në bashkësinë shkollore por edhe më gjerë, si problem që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon se si fëmijët e shohin veten, në ndjenjën e sigurisë si dhe në rizikun për zgjidhje dhe sjellje të gabueshme.

Përvojat e deritanishme tregojnë se në Maqedoni problemi me sjellje të dhunshme ignorohet ose kërkohet zgjidhje në angazhimin e agjencive profesionale për sigurim të cilat e „mbrojnë” shkollën [4].

Numri i incidenteve dhe zënkave ndoshta edhe zvogëlohet në këtë mënyrë por kjo është larg zgjidhjes së problemit me format e tjera të sjelljes së dhunshme. Në trajtimin e problemit me rëndësi është kyçja e të gjithë anëtarëve të bashkësisë posaçërisht të rinjve, në zhvillimin dhe vendosjen e mekanizmave për zgjidhjen e problemit me dhunën, përmes zvogëlimit të dimensioneve të dhunës, gjetjen e arsyeve dhe zvogëlimin e pasojave. Dituritë e fituara me hulumtimin e gjendjes dhe lidhshmëria e tyre me aksione të projektuara dhe realizuara nga fëmijët së bashku me të rriturit, mundin të përdoren për zhvillimin e politikës dhe ndërhyrjeve efektive për zvogëlimin e problemit me dhunën nëpër shkolla.

# Rezultate nga analizat dhe hulumtimet

## **Në studimin e Kombeve të bashkuara për dhunën ndaj fëmijëve**

[5] referohen tre lloje të sjelljes së dhunshme që ndodhin nëpër shkollat: ndëshkim fizik nga ana e mësimitdhënësve, si dhe ofendim dhe poshtërim të nxënësve, maltretim (fizik apo psikik në mesin e nxënësve) si dhe dhunë seksuale dhe gjinore. Të dhënat nga studimi tregojnë se ndëshkimi trupor është përditshmëri nëpër shkolla, nga 223 vende pjesëmarrëse në Studim në 106 vende nuk ka ligje të cilat e ndalojnë ndëshkimin trupor nëpër shkolla. Ndëshkimi trupor është më i shpeshtë dhe më i rreptë ndaj fëmijëve që ju përkasin grupeve që janë të stigmatizuara dhe diskriminuara në shoqëri. Zakonisht djemtë për dallim prej vajzave janë më shpesh dhe në mënyrë më të rreptë të ndëshkuar fizikisht. Kjo mënyrë e dhunshme e disiplinimit të nxënësve i mëson në frikë dhe se dhuna është mënyrë e mirë për zgjidhjen e konflikteve, por nuk i mëson në vlera si ç janë toleranca, drejtësia..... Sa i përket maltretim të dhënat tregojnë se prej 20 deri më 60% të nxënësve kanë qenë të maltretuar në shkollë majin e kaluar, më shpesh bëhet fjalë për maltretim verbal-thirrje me nofka fyese dhe ofendime.

Sipas të dhënave vajzat janë kategori më e ndjeshme, posaçërisht në aspekt të shqetësimit dhe abuzimit seksual. Ekziston një shqetësim i zmadhuar te prindërit për vajzat që udhëtojnë më gjatë nga shtëpia për në shkollë. Në disa shtete ekziston praktika që për shkak të frikës nga abuzimi seksual dhe përdhunimi vajzat ti braktisin shkollat, në fakt prindërit praktikojnë ta ndërpresin shkollimin e tyre.

Dhuna gjinore buron nga pabarazia gjinore dhe roleve gjinore të ndërtuara nga rrethanat sociale. Dhuna seksuale si dhe shqetësimi seksual i drejtuar ndaj vajzave mund të jenë të motivuara nga dëshira të dënohen ose nënçmohen vajzat për shkak të gjinisë apo seksit, ose për shkaqe dhe interes seksual. Ky lloj i dhunës përdoret për frikësim, nënçmim dhe diskriminim. Shqetësimi seksual është prezent në shkollat botërore në përmasa të ndryshme, por më shpesh haset në shkolla ku janë të pranishme edhe forma tjera të sjelljes së dhunshme. Mësimitdhënësit shpesh ngacmimet seksuale posaçërisht te vajzat, i shohin si pjesë normale të jetës shkollore dhe i injorojnë.

**Hulumtimi i cili u bë në kuadër të projektit Shkolla sipas masës së fëmijëve (dimensioni Shëndetësi, siguri dhe mbrojtje)** i përket kornizës ligjore, dmth., politikës dhe procedurave për shëndetësi, siguri dhe mbrojtje në shkollat në Republikën e Maqedonisë.

Të dhënat e fituara në katër shkolla në vendin tonë tregojnë se:

- në të shumtën e shkollave nuk ka politikë të veçantë të shkruar për të gjitha format e dhunës fizike;
- në të gjitha shkollat nuk bëhet dallim në mes dhunës (maltretim, shqetësim, rrahje, abuzim dhe neglizhim) dhe ndëshkimit trupor, arsimtarët në fjalë e citojnë Ligjin për Arsim Fillor sipas së cilit është i ndaluar vetëm ndëshkimi truporë, përderisa llojet e tjera të dhunës as që përmenden;
- nuk ka rregullativa të veçanta të cilat rregullojnë këto lloje të sjelljes, ka vetëm në disa shkolla edhe atë në formë të Kodeksit për sjelljen e mësimeve, me anë të së cilës rregullohet sjellja e mësimeve. Kodeksi për sjelljen e nxënësve me anë të së cilës rregullohet sjellja e nxënësve dhe marrëdhëniet në mes tyre në kuptim të sjelljes jo të dhunshme, si dhe rregullore për rendin e shtëpisë në të cilin rregullohen marrëdhëniet mes nxënësve, arsimtarëve dhe të punësuarve në kuptim të jo dhunës.
- në disa shkolla ku nuk ka kodekse të shkruara, marrëdhëniet mes arsimtarëve dhe nxënësve rregullohen me anë të leximit të rregullave për sjellje në orët e kujdestarisë, të arsimtarëve në mbledhjet e këshillit, dhe mandej informacioni i tillë vendohet në dërrasën për lajmërim, që të mundën të shohin të gjithë;
- masa disipline për sanksionimin e sjelljes së dhunshme të nxënësve janë të shkruara në Rregulloren për masa pedagogjike, a për arsimtarët në Ligjin për marrëdhënie pune; masat ndaj nxënësve sjellën hap pas hapi ( para përjashtim, përjashtim në klasë apo shkollë tjetër ) me anë të së cilës jepet mundësi nxënësi të përmirësohet;
- nuk ka të dhëna 5 vitet e fundit se për shkak të sjelljes së dhunshme nga ana e arsimtarëve ndonjëri prej arsimtarëve është dënuar, përveç në një shkollë ku është larguar një arsimtare;
- në dy shkolla janë dënuar tre nxënës me largimin në shkollë tjetër.

Të thënat e fituara në **Studimin për sjellje që ka të bëjë me shëndetin e fëmijëve në moshën shkollorë në R. e Maqedonisë** [6] prej vitit 2006 në mostër prej 4147 nxënës 11, 13, dhe 15 vjeçar janë gjetur të thënat e mëposhtme.

Fëmijë të cilët ndonjëherë kanë qenë të maltretuar në shkollë:

- 7% prej vajzave dhe 14% prej djemve në moshën 11 dhe 13 vjeçare;
- 5% vajza dhe 8% djem në moshën 15 vjeçare

Fëmijë të cilët ndonjëherë kanë marrë pjesë në maltretim:

- 7% prej vajzave dhe 13% prej djemve në moshën 11 vjeçare;
- 6% prej vajzave dhe 21% prej djemve në moshën 13 vjeçare;
- 7% prej vajzave dhe 20% prej djemve në moshën 15 vjeçare;

Sa ju përket zënkave hulumtimi tregon përqindje të madhe të nxënësve 15% për vajzat dhe 40% për djemtë të cilët kanë qenë pjesëmarrës.

Kjo e dhënë e vendosë Republikën e Maqedonisë në vendin e 5 në krahasim me 46 shtetet tjera pjesëmarrëse në Studim. Për nxënësit që kanë marrë pjesë në zënka më e besueshme është se pinë duhan dhe dehen, ndjehen të vetmuar, të pa pranuar, të pasigurt në vete dhe nervoz, tregojnë të dhënat nga Studimi.

Përqindje e madhe e nxënësve paraqesin se kanë mbajtur armë 30 ditëve të fundit, edhe atë djemtë shumë më shumë se vajzat. Përqindja e nxënësve të cilat mbajnë armë është më e madhe në moshën 15 vjeçare: 12% për djemtë etnik maqedonas dhe 22 % për djemtë etnik shqiptarë.

# Hulumtim për gjendjen iniciale me dhunën në shkollat fillore në Maqedoni në vitin shkollor 2008/2009

Të dhënat nga hulumtimet e deritanishme kanë të bëjnë me disa aspekte të sjelljes së dhunshme dhe me rregulloret ekzistuese në lidhje me dhunën në shkolla. Ky hulumtim bënë analizë rrënjësore të gjendjes aktuale nëpër shkolla duke identifikuar format e ndryshme të dhunës nëpër shkolla, prevalencën e formave të dhunës, frekuencën, kohën, vendndodhjen e sjelljes së dhunshme, shkaqet e sjelljes së dhunshme dhe relacionet ku ndodhin sjelljet e dhunshme arsimtar-nxënës, djalë-vajzë, dhuna ndëretnike etj.

Me hulumtimin ishin përfshirë gjithsej 1240 nxënës të tetëvjeçares të shkollave fillore në vendin tonë. Gjatë zgjedhjes së shkollave vëmendje e posaçme është kushtuar pjesëmarrjes të dy kritereve kryesore: vendi ku ndodhet shkolla dhe gjuha në të cilën mbahet mësimi. Kështu, më mostrën finale kanë hyrë shkolla nga pjesa qendrore e Shkupit, si dhe prej komunave më periferike, shkolla prej qyteteve tjera (edhe prej pjesës lindore dhe perëndimore të vendit) dhe shkolla të cilat janë të vendosura në fshatra. Njëkohësisht, në mostër janë përfshirë edhe shkolla që janë një gjuhësore (në gjuhën shqipe apo maqedonase) dhe më së paku dygjuhësore (maqedonisht-shqip, shqip, turqisht/boshnjakisht).

Për nevojat e hulumtimit ishte përpunuar pyetësorë i cili kërkonte nga nxënësit të deklarohen se si e kuptojnë/definojnë paraqitjen e sjelljes së dhunshme në shkollë dhe të japin propozime për zvogëlimin/parandalimin e sjelljes së dhunshme.

## Rezultatet

### Definimi i dhunës

Organizata botërore e shëndetësisë e definojnë dhunën si „çdo përdorim i qëllimshëm i forcës/fuqisë fizike apo psikike. Mundet të jetë në formë të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti. Mbaron (ose ka mundësi të mbaroj) me dëmtim fizik, vdekje, dëmtim psikologjik, keqëzhvillim, ose privim” [7].

Kjo dhe definicione tjera të ngjashme e përcaktojnë dhunën prej aspektit të përdorimit të dhunës fizike që mundet të trajtohet si definim i ngushtë i termit, i cili edhe në jetën e përditshme i referohet sjelljes më të gjere, veprime dhe reaksione të cilat ju përkasin aspekteve verbale, psikologjike dhe sociale të sjelljes së dhunshme.

Njëra nga definicionet e cila merr parasysh edhe këto aspekte është definicioni i maltretimimit si një formë e sjelljes së dhunshme. Në studimin ndërkombëtarë për sjelljen që ka të bëjë me shëndetin tek fëmijët e moshës shkollore maltretimi sqarohet si sjellje e dhunshme me të cilin konfirmohet fuqia interpersonale nëpër mjet të agresionit dhe definohet si „aksione negative fizike dhe verbale të cilat kanë qëllim armiqësorë ,të cilat përsëriten dhe kanë fuqi jo të barabartë mes atyre që maltretojnë dhe ato që janë të maltretuar.“ [6]

Në këtë hulumtim dhunën e definojnë fëmijët. Ky pozicionim i fëmijëve si pjesëmarrës në dialogun për kuptimin e fenomenit të dhunës i respekton principet e participimit dhe promovimin e ndjenjës autentike të fëmijëve.

Definicionet e fëmijëve tregojnë se mendimet e tyre përfshinë një pjesë të madhe të aspekteve të rëndësishme për kuptimin dhe përshkrimin e dhunës. Nxënësit sugjerojnë përdorimin e dhunës fizike, por edhe të asaj verbale për të shkaktuar dhimbje fizike apo psikike, si dhe për shkatërrimin e të mirave materiale. Gjithë ashtu, me cekjen e pirjes së duhanit si sjellje e dhunshme sugjerohet se sjellja e dhunshme jo çdoherë është e orientuar ka të tjerët por se ndonjëherë ajo mundet të jetë e orientuar edhe ka vetvetja. Fëmijët e dinë se manipulimi është sjellje e dhunshme dhe kjo tregon se dhuna nuk është vetëm përdorim eksplicit i forcës fizike por mundet të jetë edhe mënyrë subtile e përdorimit të fuqisë. Prej definicioneve të tyre mundet të lexohet se cilat janë rezultatet e sjelljes së dhunshme dhe fuqia e saj destruktive:

- ☞ „Dhunë është kur dikush më përul, më malltregon, më çon të bëjsh gjëra jashtë vullnetit,të trajton sikur të ka rob.“
- ☞ „Dhunë është kur arsimtarët i rrahin nxënësit.“
- ☞ „Sjellje e dhunshme është kur disa fëmijë vjedhin, pinë duhan dhe ju kërcënohen fëmijëve tjerë.“
- ☞ „Sjellje e dhunshme është kur nxënësit i keqpërdorin arsimtarët për nota“.
- ☞ „Dhunë është kur më shtyjnë të shahem.“
- ☞ „dhuna është kërcënim.“

Disa nxënës dhunën e përshkruajnë nëpërmjet të akteve konkrete të dhunës fizike si ç'janë thyerja, goditja, mbajtja e armës. Krahas aspekteve fizike të sjelljes së dhunshme fëmijët e cekin edhe ndikimin e fjalës „armë“ për shkaktimin e lëndimit psikik me anë të shqetësimit dhe kërcënimit:

- „Sjellje e dhunshme është kur dikush më ofendon, më shtyn dhe më bërtet.“
- „Sjellje e dhunshme është kur keqtrajtojmë ndonjë fëmijë, e godasim, i themi fjalë vulgare.“
- „Sjellje e dhunshme është kur ndonjëri prej arsimtarëve ose nxënësve i kanoset ndonjë fëmije se do ta godas, kurse mandej edhe e godet.“
- „Sjellje e dhunshme është thyerja e kaikeve, bankave dyerve, dritareve.“
- „Dhunë është kur qortohemi me shokët, kur mbajmë thikë apo armë në shkollë.“

Fëmijët tregojnë se dhuna është rezultat i dallimeve dhe pozicioneve jo të barabarta të fuqisë-më të moshuarit i malltretojnë më të vegjlit, më të fuqishmit më të dobët, djemtë vajzat, arsimtarët nxënësit. Dhuna është diskriminim dhe manipulim:

- „Dhuna është kur më i fuqishmi e malltregon dhe e përul më të dobëtin.“
- „Sjellje e dhunshme është kur arsimtarët i rrahin nxënësit.“
- „Dhuna është kur për çdo ditë djemtë e klasës sime më ngacmojnë dhe më rrahin, sikur un të jem shportë për mbeturina dhe me shqetëson se pedagogu nuk ndërmer masa për nxënësit që ngacmohen.“
- „Kërcënim i fëmijëve për të holla, rrahja e fëmijëve që janë më të vegjël dhe që i përkasin nacionalitetit tjetër.“

## Forma të sjelljes së dhunshme

Fëmijët i përgjigjeshin pyetjes se sa shpesh kanë vërejtur disa lloje të sjellës së dhunshme në shkollë e tyre. (tabela nr.1). Prej përgjigjeve mundë të shohim se forma më të shpeshta të sjelljes së dhunshme janë format e ndryshme të maltretimimit –përqeshja dhe ofendimi në mesin e nxënësve, mandej zënkat fizike dhe shkatërrimi i oredive shkollore. Sjellja e dhunshme në relacion arsimtarë –nxënës, gjithashtu

është prezentë para së gjithash në formë të ofendimit të nxënësve, por një përqindje e madhe e nxënësve (10%) deklarojë se kanë vërejtur edhe ndëshkim fizik më së paku njëherë në javë.

Përqindje e madhe e nxënësve të cilët kanë hetuar mbajtjen e thikës në shkollë, shkop dhe pistoletë.

**Tabela nr.1** **Format e sjelljes së dhunshme të cilat nxënësit i kanë vërejtur në shkollat e tyre së paku njëherë në javë (%)**

Përqeshje, ofendim në mesin e nxënësve	<b>36</b>
Zënka në mesin e nxënësve	<b>29</b>
Zënka në mesin e nxënësve të përkatësisë së ndryshme etnike	<b>15</b>
Shkatërrimin e orendive të ndryshme shkollore (karrige, banka, dyer, dritare)	<b>15</b>
Ofendimi i nxënësve nga ana e arsimtarëve	<b>11</b>
Zënka me nxënës të shkollave tjera	<b>11</b>
Ndëshkim fizik i nxënësve nga ana e arsimtarëve	<b>10</b>
Ofendimi i arsimtarëve nga ana e nxënësve	<b>9</b>
Trembja, kërcënimi nga njerëz të huaj/jashtëm	<b>9</b>
Zënka në mesin e vajzave dhe djemve	<b>8</b>
Frikësim, kërcënim ndaj nxënësve nga ana e arsimtarëve	<b>8</b>
Mbajtja e thikës nga ana e nxënësve	<b>8</b>
Mbajtja e shkopit nga ana e nxënësve	<b>8</b>
Reketim i nxënësve	<b>8</b>
Vjedhja e sendeve personale	<b>6</b>
Frikësim, kërcënim ndaj arsimtarëve nga ana e nxënësve	<b>4</b>
Mbajtja e pistoletës nga ana e nxënësve	<b>4</b>
Ndëshkim fizik të mësimitdhënësve nga ana e nxënësve	<b>4</b>

# Si dhe ku ndodhën sjellja e dhunshme në shkollë


Nxënësit përgjigjeshin edhe në pyetje se në cilat vende në shkollë ndodhin zënkat, kur dhe cilat janë shkaqet për ndodhjen e tyre.

Sipas nxënësve zënkat më shpesh ndodhin në ato vende ku ato e kalojnë pjesën më të madhe të kohës së lirë, në oborrin e shkollës dhe korridoret, por edhe në klasat (grafiku nr.1). Më shpesh zënkat ndodhin gjatë kohës së pushimeve dhe në periudhën e ardhjes dhe kthimit nga shkolla (grafiku nr.2), kur fëmijët janë jashtë vëzhgimit dhe kontrollit të të rriturve.

**II. Grafiku nr.1** Vendet ku më shpesh ndodhin zënkat (%)




**II. Grafiku nr. 2** Koha kur ndodhin zënkat (%)



Shkaktarë më të shpeshtë për zënkat sipas nxënësve janë mosdurimi dhe mungesa e mirkuptimit, thirja me nofka fyese, ofendimi, xhelozia. (Grafiku nr.3)

**II. Grafiku nr.3 Shkaqet më të shumta për rrahjet (%)**



## Ballafaqimi me dhunën

Nxënësit jepnin propozimet e tyre se si të zvogëlohet dhuna nëpër shkolla. Numri më i madh i ideve ishte për zmadhimin e kontrollit dhe sanksioneve. Nxënësit kërkonin mbrojtje dhe vëzhgim, përmendnin sigurimin dhe video kamerat, kujdestari nëpër korridore dhe oborrin (vendet ku më shpesh ndodhin sjelljet e dhunshme), paraqitet edhe ideja për prezencën e policëve. Disa nxënës konsiderojnë se duhet të zmadhohet dënimi, të gjenden masa përkatëse për ato që praktikojnë dhunën. Gjithashtu, se duhet të zmadhohet kontrolli nga ana e mësimit dhe prindërve. Numri i madh i ideve ishte për zgjidhje konstruktive dhe paqësore të problemit. Prej propozimeve të nxënësve vërejmë se ato kanë nevojë për bashkëpunim më të madh, mirëkuptim dhe vëmendje nga ana e të rriturve, prindërit dhe mësimit.

Ato janë ideale se duhet të tejkalohen situatat dhe ndjenjat e padëshiruara-zënkat, xhelozit, zilia, provokimet, ofendimet, paragjykimet, stereotipat, urrejtja, me zmadhimin e tolerancës, durimit, ndihmës, dashurisë, komunikimit, shoqërimin dhe zbatimit.

Ekzistojnë edhe ide që janë të orientuar nga ndarja, në shkolla apo ndërrime të ndryshme dhe kanë të bëjnë me përkatësit e ndryshme etnike.

Më në fund numër më i vogël i nxënësve theksojnë se kushtet në të cilat mësojnë mundet të jenë shkak për paraqitjen e sjelljes së dhunshme dhe kërkojnë kushte më të mira dhe organizim më të mirë të mësimit.

Shpalosja e ideve të nxënësve se si mundet të zvogëlohet sjellja e dhunshme në shkollë të shpërndara në kategori:

## 1 Kontollim, sanksione, sigurim, disiplinë...

- *Sigurimi të zmadhohet, të përmirësohet, të vendoset, të forcohet, ta kryej detyrën e vet, të ketë në derë, në korridor dhe në oborr*
- *Masat – Të ketë më shumë masa, sanksione, dënime, të jenë më të rrepta, masa përkatëse pedagogjike.*
- *Mbikëqyrja vizuale – të ketë kamera, mbikëqyrje, në koridore në derën e hyrjes;*
- *Dëbimi nga shkolla të nxënësve problematik, të cilët nuk vinë në shkollë, të cilët zihen, të cilët nuk i respektojnë rregullat dhe ligjet.*
- *Të ketë kontroll dhe disiplinë më të madhe, më të rreptë nga ana e profesorëve për sjelljen e nxënësve.*
- *Ndalimi për hyrjen e personave, nxënësve që nuk mësojnë në shkollë;*
- *Policia – pjesëmarrja e policisë në oborr, në shkollë;*
- *Kontrollimi në derë për posedimin e armëve etj.*
- *Mësimdhënës kujdestar nëpër koridore, në tualete, në pushime dhe në oborr...*
- *Dënim me të holla për nxënësit e dhunshëm*

## 2. Bashkëpunimi dhe zgjidhja e problemeve

☞ *„Me të rrahur nuk do të zgjidhet asgjësend por me mirëkuptim. Nuk ka efekt nëse mësimdhënësi apo drejtoresha i rreh ato që kanë bërë ndonjë punë të pahijshme.“*

☞ *„Duhet të shënohet notë e saktë, për shkak se për notë më të madhe të nxënësve tjerë, mundet të vijë deri në zënkë..“*

- *Profesorët më shumë të bashkëpunojnë me nxënësit, të miqësohen me të, të kenë mirëkuptim, të bisedojnë, të jenë më të vëmendshëm, të jenë përgjegjës, nxënësit të jenë më të lirë me ato, të këshillohen*
- *Prindërit të bashkëpunojnë me mësimdhënësit, dhe nxënësit, të jenë të pranishëm më shpesh në shkollë, të ketë më shpesh mbledhje prindërore, të marrin pjesë në debatet e shkollës, projektet.....*
- *Kontroll dhe edukim i zmadhuar nga ana e prindërve, kulturë shtëpiake, kujdesi e nga ana e prindërve, prindërit tu kushtojnë më shumë vëmendje*
- *Zgjidhja e problemeve me biseda, këshillime, kompromis, në mënyrë paqësore, biseda për problemet*
- *Mos të ketë qortime, xhelozie, zili, provokime, ofendime, paragjykime, stereotip, urrejtje*

- Tolerancë, sjellje, kulturë, respekt i ndërsjellët, durim, ndihmë, mirëkuptim për nxënësit me probleme
- Shoqërim, dashuri, ekskursione të përbashkëta
- Biseda me persona kompetent, këshillime, bashkëpunim me psikolog, pedagog
- Mos të humben orë, mos ketë mungesa, mos të largohen nxënësit nga ora
- Të i dëgjojmë profesorët, mos të jemi me shoqëri te keqe

### 3. Edukimi

„Me më shumë orë edukative për dhunën, fëmijët do të kuptojnë pse nuk duhet të ketë dhunë dhe cilat janë pasojat e sjelljes së dhunshme.“

„Duhet të mbahen orë në të cilat do të flitet për problemet që i mundojnë nxënësit, se për shkak të atyre problemeve ndodhin zënkat.“

- Të mësojmë, edukim, mbajta e orëve për sjellje jo të dhunshme, biseda me shërbimin pedagogjik për problemet që i mundojnë nxënësit, orë plotësuese një herë në javë.....
- Projekte, seksione
- Të ketë më shumë angazhime të ndryshme-loja, kufize, shëtitje
- Më shumë aktivitete fizike, sport etj.

### 4. Ndarjet

„Mos të ketë nxënës të përkatësisë tjetër, më saktë mos të mësojnë në këtë shkollë për shkak se ato e prishin rendin e shkollës, mbajnë thika dhe boks të hekurt dhe shpesh na kërcënohen. Në një zënkë u lëndua një shok i imi...“

- Mos të mësojnë bashkë nxënës të përkatësisë së ndryshme etnike (të ndahen në ndërrime ose të ndërtohen shkolla të reja)

### 5. Kushtet

„Nëse në shkollë ka kushte më të mira, atëherë nxënësit do të jenë të angazhuar dhe nuk do të kenë kohë për marrëzira.“

- Orë më mirë të organizuara

## Përfundime

Mënyra se si fëmijët flasin për dhunën si pjesë e përditshmërisë së tyre tregon se ata janë të vetëdijshëm për sjelljen e dhunshme që i rrethon si dhe për rolin dhe pjesëmarrjen e tyre dhe se i kuptojnë pasojat nga kjo sjellje, edhe pse në shikim të parë na duket se sjelljet e dhunshme që më shpesh paraqiten në shkollë trajtohen si normale dhe të pranueshme, si pjesë e lojës së fëmijëve dhe si diçka që të gjithë ne e kemi kaluar.

Të thënat për at se sa shpesh ndodhin disa lloje të sjelljes së dhunshme flasin për praninë e të gjitha sjelljeve të dhunshme në shkollë. Kjo mundet të krijoj pasqyrë për shkollën si vend i cili nuk është i sigurt sa duhet, në të cilin sjellja e dhunshme është përditshmëri dhe si mënyrë e lejuar për zgjidhjen e problemeve.

Të dhënat për atë se ku dhe kur më shpesh ndodhin sjelljet e dhunshme shpesh përdoren si argument për masa disiplinore të cilat ndërmerren me qëllim „sharjen“ e sjelljes së dhunshme gjatë së cilës edhe më shumë ngushtohet rrethi i lirisë dhe lojës të fëmijët. Kështu në vend të kohës së organizuar dhe kushteve për lojë, shoqërim dhe zbatimje nëpër shkollë vendosen kamera për mbikëqyrje ose angazhohen roje fizike të cilat e ndjekin dhe kontrollojnë çdo lëvizje të fëmijëve.

Përvojat e deritanishme për këtë mënyrë të disiplinimit tregojnë se kontrolli dhe mbikëqyrja çdoherë sjellin forma të reja të rezistencës, fëmijët çdo herë do të gjejnë kohë dhe vend ku do të mundën të kundërshtojnë rregullat të cilat i kufizojnë dhe i shtypin. Kësaj i ndërlidhet edhe fakti se numri më i madh i ideve që kanë të bëjnë me atë se si duhet të kundërvihemi dhunës janë për dënime dhe kontroll. Disiplinimi dhe dënimi janë mënyrat më tradicionale me përballjen e sjelljes jo të dëshirueshme të fëmijët. Ajo që është problematike me këto mënyra është se edhe vetë janë të dhunshme dhe i bashkëngjiten rrethit –dhuna çdoherë lindën dhunë. Nga ana tjetër këto të dhëna na sugjerojnë se fëmijët kanë nevojë që të mbrohen prej sjelljes së dhunshme. Shkaqet që fëmijët i japin për sjelljen e dhunshme na i bëjnë me dije se jo njohja, paragjykimet, dhe stereotipat për Tjetrin, i cili mund të jetë tjetri për shkak të gjinisë, entitetit, hendikepit, kulturën, pamjen, religjionin, prejardhjen etj. mund të gjenerojnë dhe stimulojnë dhunën e llojeve të ndryshme. Të dhënat e këtylla tregojnë se ka nevojë për hapjen e pyetjeve për marrëdhëniet me të tjerët, për mënyrën e zgjidhjes së konflikteve, stereotipat, dhe paragjykimet si aspekte të rëndësishme kur flasim për sjelljen e dhunshme. Në këtë drejtim ka nevojë për krijimin e programeve të cilat do të promovojnë respektimin e dallimeve, eupati dhe mendim kritik në vend të disiplinës dhe kontrollit.

# Rekomandime

- Definim i përbashkët i sjelljes së dhunshme që të mundë të zbatohet dijaogu për krijimin e aktiviteteve preventive dhe aktiviteteve për tu kundërvënë sjelljes së dhunshme.
- Marrja e përgjegjësisë dhe pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të bashkësisë shkollore në krijimin dhe zbatimin e masave preventive dhe masave për sjelljen e dhunshme.
- Vendosjen e politikës nacionale, procedurave dhe mekanizmave për prevenim dhe kundërvënie dhunës në shkollë
- Zhvillim të politikës shkollore, procedura dhe protokolle për prevenim dhe kundërvënie sjelljes së dhunshme,
- Hapja e temës për dhunën e bazuar në dallimet gjinore, shqetësimin dhe abuzimin seksual të cilat janë ende tabu në shkolla;
- Promovimi i diturisë dhe shkathtësive për dhunën
- Implementimi i aktiviteteve dhe programeve për njohjen dhe respektimin e dallimeve, bashkëpunim dhe aktivitete të përbashkëta në mes nxënësve të grupeve të ndryshme;
- Bashkëpunim më i madh i shkollave me bashkësitë lokale, institucione dhe organizata tjera, me qëllim të mundësohet mbrojtja e të drejtave të fëmijëve..
- Hapja e temës për dhunën gjinore, shqetësimin seksual dhe abuzimin të cilat ende janë tabu tema nëpër shkolla;
- Promovimi i diturive dhe shkathtësive për jo dhunë.
- Mbajtja e aktiviteteve dhe programeve për njohjen dhe respektimin e dallimeve, bashkëpunim dhe aktivitete të përbashkëta në mes nxënësve të grupeve të ndryshme.
- Bashkëpunim më i madh i shkollave me bashkësitë lokale, institucionet dhe organizatat tjera, me qëllim që të mundësohet kujdesi dhe mbrojtja e plot e të drejtave të fëmijëve.



Projekti i përbashkët i Kombeve të  
Bashkuara për Preventivën e dhunës të  
përkrahur nga UNICEF – i, i financuar nga  
qeveria Holandeze



Биро за развој на образованието  
на Република Македонија



Алгоритам центар